



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/909  
Datë: 1 / 8 / 2023

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 173, paragrafi 4 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, Rregulloren me nr. 1/95, datë 24.06.2021, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në Universitetin e Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datën 28.7.2023, vendosi të shpallë:

### **KONKURS PLOTËSUES**

#### ***Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për vitin akademik 2023/24***

Angazhimi me honorar i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime do të bëhet sipas propozimit të njësive akademike, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-037, dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (tutje UP), Rregulloren me nr. 1/95, datë 24.06.2021 për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në UP dhe rregullativën për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.

#### **I. Procedura e angazhimit sipas konkursit dhe përjashtimet për kategoritë e caktuara**

Procedura e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime bëhet në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik, përveç përjashtimeve të parapara me Rregulloren me nr. 1/95, datë 24.06.2021, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

#### **II. Kushtet e angazhimit**

1. Personat e angazhuar në cilesinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje akademike. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara në Rregulloren me nr. prot. 1/95, date 24.6.2021, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP.
2. Në Universitetin e Prishtinës nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë me shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo honorar në institucione publike apo private me pagë primare apo sekondare.
3. Në Universitetin e Prishtinës, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjerës prej strukturave themelore organizative (katedër, degë, departament apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
4. Kandidatët e punësuar/angazhuar në ndonjërin prej institucioneve private të arsimit të lartë apo në institucione tjera private dhe publike, angazhimi në të cilat bie ndesh me interesat apo cilësohet si konkurrencë ndaj UP-së, obligohen që së paku tri (3) ditë para vendimmarrjes në Këshillin e Fakultetit, ta dorëzojnë pranë fakultetit përkatës deklarinimin me shkrim për dorëheqje nga institucioni ku janë të punësuar/angazhuar me rastin e angazhimit të UP.

### **III. Fondi i orëve për bashkëpunëtorët e jashtëm**

1. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata dhe profesoret vizitorë mund të mbajnë **deri në gjashtë (6) orë** në javë.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë **deri në dhjetë (10) orë** në javë.

### **IV. Kohëzgjatja e kontratës për honorar dhe kompensimi**

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për një semestër përkatësisht për dy semestra të të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet prej datës 1 tetor deri me 30 shtator të vitit përkatës akademik.
2. Kompensimi për angazhim bëhet në bazë të orëve të realizuara, respektivisht për semestrin dimëror prej datës 1 tetor deri me datë 15 janar, ndërsa për semestrin veror prej datës 16 shkurt deri me datë 31 maj të vitit përkatës akademik.
3. Vlera e kompensimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për pagat e zyrtarëve publikë dhe aktin e brendshëm të UP-së në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.
4. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës të mbajë provirnet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik.
5. I angazhuari, nëse ka titullin Dr. sc. ose ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve, ka të drejtë të mentorojë kandidatët në nivelin Bachelor, me kusht që mbrojtja e temave të diplomës të semestrit dimëror të përfundojë më së largu deri me 15 prill, kurse të semestrit veror më së largu deri me 30 shtator të vitit përkatës akademik.
6. I angazhuari mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e temave në nivelin bachelor dhe master.

### **V. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim**

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim;
- b) Biografinë (CV);
- c) Çertifikatën/ekstraktin e lindjes (jo më të vjetër se 6 muaj);
- d) Kopjen e diplomës përkatëse të vërtetuar me vulë origjinale nga noteri, për secilën pozitë që aplikon;
- e) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për angazhim duhet të sjellin vendimin për nostrifikim (barasvlerë) të diplomës përkatëse (bachelor, master, magjistraturë, doktoratë) ose dëshminë e aplikimit për nostrifikim. Nëse me rastin e aplikimit, kandidati dorëzon vetëm dëshminë e aplikimit për nostrifikim, vendimi për nostrifikim të diplomës/ave përkatëse të fituar jashtë vendit domosdoshmërisht duhet të dorëzohet më së largu tri (3) ditë para mbledhjes së Këshillit të Fakultetit në të cilin vendoset për lëndën përkatëse;
- f) Kandidatët, të cilët konkurrojnë për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime, lektorit dhe korepetitorit duhet të sjellin edhe certifikatën origjinale të notave të studimeve bachelor dhe atyre master, ose kopjen e noterizuar me vulë origjinale nga noteri;
- g) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale brenda komizës së përcaktuar më Statutin e UP-së dhe rregulloret respektive në fuqi për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik, linku: <https://dokumente.uni-pr.edu>
- h) Dëshmitë për angazhimet paraprake në UP ose në ndonjë institucion të akredituar publik të arsimit të lartë, dëshmi për së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën përkatëse dhe dëshmi për specializimin e perfunduar (Mjekësi);

- i) Dëshmi të lëshuar nga Gjykata Themelore jo më të vjetër se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar apo nen hetime;
- j) Dëshmi tjera relevante për pozitën në të cilën aplikon;
- k) Aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara në këtë konkurs nuk do të pranohen fare nga administrata përkatëse e fakulteteve.

## **VI. E drejta e ankesës**

1. Fakultetet obligohen që të themelojnë komision për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Komisioni i ankesave i përbërë prej tri (3) ose pesë (5) anëtarëve emërohet nga Këshilli i Fakultetit dhe në përbërjen e tij nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të fakultetit.
3. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankesë pranë komisionit për ankesa në fakultetin përkatës, brenda tetë (8) ditëve nga dita e marrjes së vendimit në Këshill të Fakultetit. Ankesa duhet të dorëzohet në fakultetin përkatës.
4. Komisioni i ankesave më se largu tri (3) ditë pas perfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës të njëjten ditë e dorëzon në këshill të fakultetit. Këshilli i Fakultetit në afat prej tri (3) ditësh nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendosë për miratim ose refuzim të tij.
5. Shqyrtimi i ankesave dhe marra e vendimit përkatës në Këshillin e fakultetit është vendim përfundimtar në nivel Universiteti.
6. Dekani i fakultetit, pas shqyrtimit të ankesave eventuale, në mbledhjen e parë të Senatit, i njofton senatorët më listën e kandidatëve të angazhuar.
7. Kundër vendimit të Këshillit të fakultetit, pala e pakënaqur mund të fillojë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
8. Dekani i fakultetit, në bazë të nenit 72, paragrafi 2 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Vendimit me nr. prot. 2/58, datë 11.7.2017 të Këshillit drejtues të UP-së, autorizohet ta përfaqësojë Universitetin në emër të Fakultetit lidhur me vendimet e marra në përputhje me Rregulloren për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në versionin elektronik, në adresën elektronike [angazhimi@uni-pr.edu](mailto:angazhimi@uni-pr.edu).

Aplikacionet e arritura pas afatit, ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi publikohet në faqen zyrtare të UP-së <https://www.uni-pr.edu>, në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike, respektivisht prej datës **2.8.2023** deri me datën **16.8.2023**.

## Konkursi shpallet sipas propozimeve të njësive akademike dhe atë si në vijim:

### I. FAKULTETI FILOZOFIK

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Psikologji personaliteti (O), Testimi, vlerësimi dhe diagnostifikimi në psikologjinë klinike (O), Psikologji motivacioni (O), Çështjet etike dhe profesionale në shëndetin mendor (O).
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Hyrje në psikologji (O), Këshillimi psiko – social (O), Psikologji sociale (O), Psikologji zhvillimore (O).
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Puna me të rinjë (O), Aftësi e kufizuar: studime kritike (O), Shëndeti mental në komunitet (O).
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Hyrje në politikat sociale (O), Metodatat e punës sociale (O).
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Mirëqenia e fëmijëve (Z), Të drejtat e njeriut (Z).
6. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Zhvillimi profesional dhe shkrimi i projekteve (Z), Teori edukimi (Z), Komunikimi profesional (Z).
7. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Artitekturë ilire (Z), Histori antike (O).
8. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Kërkimi dhe shkrimi etnografik (Z), Antropologjia e shtetit (O), Artet tradicionale, Antropologji e Evropës dhe Evropës Juglindore (O), Kultura materiale dhe konsumi (Z).
9. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Trashëgimia kulturore e Kosovës (Z), Legjislacioni arkivor (Z).
10. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Gjuhë osmane.
11. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Histori e vjetër shqiptare, Histori mesjetare shqiptare, Histori botwrore mesjetare I, Histori e Evropës Juglindore I, Histori botërore mesjetare II, Histori e Bizantit.
12. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Histori botërore bashkëkohore I (O), Histori botërore bashkëkohore II (O), Historiografi shqiptare shek. XIX-XX (O), Histori ekonomike e Ballkanit XIX-XX (O), Standardet ndërkombëtare të arkivistikës (Z), Konservimi dhe restaurimi i lëndës arkivore (Z), Rregullimi i lëndës arkivore specifike (Z).
13. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Hyrje në filozofi (O), Filozofi e teknologjisë (O), Histori e filozofisë I – Filozofi antike (O), Filozofia e subjektit (O), Konceptet filozofike të Platonit dhe Aristotelit (O), Autorët e përzgjedhur nga filozofia bashkëkohore (O), Filozofi e arkitekturës (Z).
14. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Histori e filozofisë II – Empirizmi dhe racionalizmi (O), Histori e filozofisë III, Idealizmi klasik gjerman (O), Filozofi e shkencës dhe metodologji (O), Hyrje në metafizikë dhe ontologji (O), Problemet kryesore të filozofisë moderne (O).
15. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Politika, religjioni dhe kultura (O), Arti dhe shoqëria (O), Estetikë (O), Filozofi e të drejtave të njeriut (Z).
16. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Filozofi e së drejtës (O), Filozofi politike II (O), Debatet mbi globalizmin (Z), Filozofi e së drejtës (Z), Filozofi politike I (O),
17. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Hyrje në sociologji (O), Sociologji e sportit (Z), Sociologji e globalizmit (O), Teoritë e avancuara sociologjike (O), Teoritë bashkëkohore të sociologjisë (O), Integrimet dhe globalizmi (O).
18. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Metodatat kuantitative në sociologji (O), Sociologji e religjionit (Z), Sociologji e të drejtave të njeriut dhe drejtësia sociale (Z), Lëvizjet shoqërore dhe protesta (Z), Të drejtat e njeriut dhe drejtësia sociale

- (Z), Sociologji politike (O), Sociologji e jetës së përditshme (O), Teoritë dhe modelet e demokracisë (Z), Edukimi qytetar dhe demokracia (O).
19. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Antropologji sociale (Z), Sociologji e punës (Z), Sociologji e identitetit (O), Sociologji e arsimit (Z), Krimi dhe kontrolli social (Z), Kombi dhe nacionalizmi (Z), Sociologji e punës (Z), Kombi dhe nacionalizmi (Z).
  20. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Shkrimi akademik (O), Teoritë klasike të sociologjisë (O), Teoritë sociale postmoderne (Z).
  21. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Të drejtat e njeriut (O), Hyrje në politikat sociale (O), Puna me të rinjtë (O), Socializimi dhe integrimi (Z), Metodatat e punës sociale (O), Bazat e statistikës dhe hulumtimet kuantitative (O).
  22. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Mirëqenia e fëmijëve (O), Aftësitë e kufizuara: Studime kritike (O), Komunikimi profesional (Z), Zhvillimi profesional dhe shkrimi i projekteve (Z), Teori edukimi (Z).
  23. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Arkeologji e kohës së gurit (O), Arkeologji e kohës së metaleve (O), Arkeologji e Evropës Juglindore (O), Arkeologji mesdhetare (O), Numizmatikë ilire (O), Arkeologji mesjetare (O), Kulturë ilire (Z), Hapësirat sakrale në Kosovë (Z), Arkeologji mesjetare ballkanike (Z), Arkeologji dardane (Z).
  24. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Antropologji e gjinisë (O), Antropologji e së drejtës dhe ligjit (O), Migrimi dhe siguria sociale (O), Struktura dhe organizimi shoqëror (O), Antropologji e ushqimit (O), Veshjet dhe identiteti (Z), Teoritë etnologjike dhe antropologjike (Z).
  25. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Hyrje në trashëgimi kulturore (O), Studimet e familjes në perspektivë krahasuese (O), Trashëgimi kulturore (O), Festat dhe festivalet (Z), Metodatat dhe teknikat e hulumtimit (Z), Menaxhimi i trashëgimisë kulturore (Z).
  26. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Psikologji zhvillimore e avancuar (O), Analiza dhe modifikimi i sjelljes në shkollë (O), Testimi psikologjik (O), Psikologjia e familjes (Z), Çështje etike dhe profesionale në shëndetin mendor (Z), Psikopatologji e avancuar (O), Praktikum 1 (O), Zhvillimi dhe vlerësimi i programeve (O), Psikologjia e shëndetit dhe mirëqenies (O), Testimi, vlerësimi dhe diagnostikimi në psikologjinë klinike (O). Teoritë bashkëkohore të intervenimit në komunitet (O).
  27. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Psikologji edukimi & teoritë e të nxënies (O), Psikologji edukimi e avancuar (O), Menaxhimi i arsimit (O), Shkrimi akademik për psikologji (O), Psikologji e përgjithshme (O), Psikologji sociale (Punë sociale) (O), Psikologji zhvillimore (Punë Sociale) (O).

## II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

1. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për grup lëndësh nga Kimia Organike.
2. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për grup lëndësh nga Kimia Analitike.
3. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për grup lëndësh nga Kimia Fizike.
4. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjerata, për lëndët e shkencës kompjuterike (Departamenti i Matematikës).
5. Pesë bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët e matematikës.
6. Gjashtë bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët e shkencës kompjuterike.
7. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët e ekonomisë.
8. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët: Biologji e qelizës me histologji, Bch – Biologji (O), Biologji e zhvillimit, Bch – Biologji (O). (Departamenti i Biologjisë).

9. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët: Ekologjia e ekosistemeve, Biologjia e konzervimit, Fauna e Kosovës, Biologji e llojeve invazive, Principet e akuakulturës, Ekologji e sjelljeve të kafshëve. (Dep. i Biologjisë).
10. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët: Makro dhe mikroanatomia e shtazëve laboratorike (Z – Bio), Ihtiologjia (Z – Bio), Ekofiziologji (O), Ekotoksikologji (O), Parimet e qëndrueshmërisë mjedisore, Kapituj të zgjedhur nga fiziologjia animale, Përparimi i shtazëve, Menaxhimi i tokave. (Dep. i Biologjisë).
11. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët: Gjeomorfologjia I, Klimatologji me meteorologji, Gjeomorfologjia II, Gjeomorfologjia aplikative. (Dep. i Gjeografisë)
12. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët: Gjeografia ekonomike, Pedogjeografia, Gjeografia nacionale I, Gjeoekonomia, Metodatat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike, Gjeostatistika, Gjeografia e turizmit, Gjeografia nacionale II. Gjeografia e transportit.
13. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për lëndën: Gjuhë angleze I dhe II (Dep. Mat).
14. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për lëndën: Gjuhë angleze I dhe II (Departamentet: Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjeografi).
15. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për lëndën: Shkrim akademik.

### III. FAKULTETI I FILOLOGJISË

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Fonetikë dhe fonologji e shqipes së sotme (Gjuhë Shqipe BA), Dialektologji (Gjuhë Shqipe, BA), Morfologji (Letërsi Shqipe, BA), Hyrje në gramatikë teksti të gjuhës shqipe (Gjuhë Shqipe, BA), Sintaskë (Letërsi Shqipe, BA), Sintaskë e gjuhës amtare (Ballkanistikë, BA).
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Gjuhë Shqipe 1 (Gjuhë Frënge, Orientalistikë), Gjuhë shqipe 1 (Gjuhë Angleze, BA), Norma e gjuhës amtare (Ballkanistikë) dhe Gjuhë Shqipe 1 (Gjuhë Turke), Gjuhë e sotme amtare (shqipe) (Ballkanistikë) dhe Gjuhë Shqipe 2 (Gjuhë Turke), Gjuhë Shqipe 2 (Gjuhë Turke, Orientalistikë, Gjuhë Frënge), Gjuhë shqipe 2 (Gjuhë Angleze, BA).
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Norma e shqipes së shkruar (Gjuhë shqipe, BA), Sintaksë e shqipes 1 (Gjuhë Shqipe, BA), Shqipja e shkruar (Letërsi Shqipe, BA), Sintaksë e shqipes 2 (Gjuhë shqipe, BA), Norma e shqipes së folur (Gjuhë Shqipe, BA).
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Psikolinguistikë I (Gjuhë Shqipe, BA), Morfologji I - Sistemi emëror i shqipes (Gjuhë Shqipe, BA), Psikolinguistikë II (Gjuhë Shqipe, BA), Morfologji II – Sistemi foljor i shqipes (Gjuhë Shqipe, BA).
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Letërsi popullore I, (Letërsi shqipe), Bazat e retorikës (Letërsi shqipe), Hyrje në estetikë (Letërsi shqipe), Letërsi shqipe (Letërsi shqipe), Kurs monografik (Letërsi shqipe), Letërsi popullore II (Letërsi shqipe), Letërsi për fëmijë (Letërsi shqipe), Estetika e letërsisë (Letërsi shqipe), Format letrare (Letërsi shqipe).
6. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Letërsi paramoderne shqipe, Poezia shqipe, Metodologji e hulumtimit shkencor, Teori letrare (MA), Sociologji e letërsisë, Kurs monografik (MA), Poetika, Letërsi moderne shqipe, Tematologji, Kritikë letrare, Romani shqiptar.
7. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Morfologji 1, Sintaksë 1, Fonetikë e gjuhës angleze, Morfologji 1, Sintaksë 1, Fonetikë e gjuhës angleze, Morfologji 2, Sintaksë 2, Fonologji e gjuhës angleze.
8. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Gjuhe angleze III (Gjuhë dhe Letërsi Angleze), Anglishtja për qëllime akademike I (Gjuhë dhe Letërsi Angleze), Anglishtja për qëllime akademike I (Gjuhë dhe Letërsi Angleze), Gjuhe Angleze IV

- (Gjuhe dhe Letërsi Angleze), Anglishtja për qëllimë akademike II (Gjuhë dhe Letërsi Angleze), Anglishtja për qëllime akademike II (Gjuhë dhe Letërsi Angleze).
9. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Gjuhësi e tekstit (MA) Z, Strukturë e gjuhës angleze (MA), Gjuhë angleze I (Gjuhë gjermane), Fonetikë e gjuhës angleze, Leksikologji, Gjuhë angleze II (Gjuhë gjermane), Pragmatikë, Fonologji e gjuhës angleze.
  10. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Letërsi moderne amerikane, Shekspiri, Letërsi angleze prej vitit 1837 deri në vitin 1945, Kritikë letrare bashkëkohore, Pasqyrë e letërsisë amerikane, Letërsi bashkëkohore amerikane, Shkrimi feminist, Interpretimi i veprave letrare.
  11. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Hyrje në letërsinë gjermane, Letërsi gjermane: Baroku deri te Iluminizmi, Letërsi gjermane: Romantizmi deri te Revolucioni i Marsit, Analizë e teksteve letrare, Letërsi gjermane: Ekspresionizmi deri te Raju i Tretë, Letërsi gjermane: Mesjeta deri te Humanizmi, Letërsi gjermane: Sturm und Drang dhe Klasika, Letërsia gjermane: Realizmi deri te Simbolizmi, Letërsi gjermane pas 1945.
  12. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Letërsi frënge Mesjeta, Letërsi frënge Klasicizmi, Frëngjishtja për qëllime specifike, Metodikë e gjuhës frënge, Didaktikë e gjuhës frënge, Letërsi frënge Renesanca, Letërsi frënge Iluminizmi, Didaktikë e hartimit të teksteve, Metodikë me praktikë shkollore.
  13. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Gjuhë Frënge I, Morfologji e gjuhës frënge, Gjuhë Frënge III, Gjuhë Frëngë II, Fonetikë, Gjuhë Frënge IV, Morfonistikë, Gjuhë frënge VI, Leksikologji.
  14. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Qytetërim Islam 1, Gjuhë Osmane I, Qytetërim Islam 2, Gjuhë Osmane II.
  15. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Zhanret e Gazetarisë I, Media dhe politika, Zhanret e gazetarisë II, Metoda kërkimi në shkencat sociale.
  16. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Hyrje në gazetari, Radiogazetaria, Raportimi, Komunikimi organizativ.
  17. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Mediet e reja dhe portalet, Media dhe drejta, Teori dhe praktikë e Marrdhenieve me Publikun, Gazetari sportive.
  18. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Bazat e komunikimit masiv I, Opinioni publik, Hyrje në teorinë e komunikimit, Metoda kërkimi në shkencat e komunikimit, Bazat e komunikimit masiv II.
  19. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Produksion dhe postproduksion, Çrregullimi informativ dhe pas-e-vërteta, Komunikimi politik, Gazetari hulumtuese, Intervista & talkshou.
  20. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Sistemi politik i Kosovës, Multikulturalizmi, Marketing dhe advertajzing, Sociologji e komunikimit.
  21. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjerata për lëndën: Dikson.
  22. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndën: Dikson.

#### IV. FAKULTETI EKONOMIK

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjerata për lëndët: Gjuhë e huaj Angleze I (Menaxhment, Ekonomik, BA-O), Gjuhë e huaj Angleze I (Banka dhe Financa, Marketing, BA-O), Gjuhë e huaj Angleze I (Kontabilitet, BA-O), Gjuhë e huaj Angleze II (Menaxhment, BA-O), Gjuhë e huaj Angleze II (Marketing, BA-O), Gjuhë e huaj Angleze II (Banka dhe Financa, BA-O).
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjerata për lëndët: Gjuhë e huaj Frënge (Ekonomik, BA-Z), Gjuhë e huaj e ndërmjetme Frënge (Ekonomiks, BA-Z), Gjuhë e huaj Frënge I

- (Marketing, Kontabilitet, BA-Z), Gjuhë e huaj Frënge I (Financa, BA-Z), Gjuhë e huaj Frënge II (Marketing, BA-Z), Gjuhë e huaj Frënge (Ekonomiks, BA-Z).
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Tregje Financiare (Banka dhe Financa, BA-O), Financa Ndërkombëtare (Banka dhe Financa, BA-O), Financa Publike (Banka dhe Financa, OB-O), Menaxhment Financiar (Banka dhe Financa, BA-O), Financa të Korporatave (Banka dhe Financa, BA-O).
  4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Auditimi (Kontabilitet, BA-O), Analizë Financiare (Kontabilitet, BA-O), Tatimet dhe strategjia e biznesit (Banka dhe Financa, BA-O), Kontabilisti në biznes (Kontabilitet, BA-Z), Kontabilitet (Kontabilitet, BA-O).
  5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Vlerësimi financiar i bizneseve (Banka dhe Financa, BA-Z), Buxheti publik dhe thesari (Banka dhe Financa, BA-O), Financa (Banka dhe Financa, BA-O), Banka dhe afarizëm bankar (Banka dhe Financa, BA-O), Qeverisja financiare (Kontabilitet, BA-Z), Ndërmarrësia (Banka dhe Financa, BA-Z).
  6. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Etika profesionale në kontabilitet dhe auditim (Kontabilitet, O), Kontabiliteti ndërkombëtar (Kontabilitet, Z), SNRF për NVM (Kontabilitet, Z), Sistemi informatik i Kontabilitetit (Kontabilitet, Z), Auditimi i jashtëm (Kontabilitet, O), Kontabiliteti i institucioneve financiare (Kontabilitet, O), Kontabiliteti i bankave (Banka dhe Financa, Z).
  7. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Financa në biznes (Menaxhment, BA-O), Parimet e menaxhmentit (Kontabilitet, BA-Z), Ndërmarrësia dhe menaxhimi i NVM-ve (Menaxhment, ba-o), Menaxhment (Menaxhment, BA-O), Menaxhimi i operacioneve (Menaxhment, BA-O).
  8. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Teknologjia informatike e menaxhmentit të projektit (BA-O), Informatika (Menaxhment, Banka dhe Financa, Marketing, Kontabilitet, BA-O), Menaxhimi i informatave (Menaxhment, BA-Z), Analiza e të dhënave në menaxhment dhe ekonomi (Ekonomiks, BA-Z), Biznes elektronik (Menaxhment, BA-Z).
  9. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Hyrje në biznes (Ekonomiks-o, Marketing-Z, Menaxhment BA-O), Ekonomiksi i migracionit (Ekonomiks, BA-O), Ekonomia e Kosovës dhe BE (Ekonomiks, BA-Z), Ekonomia monetare (Banka dhe Financa, BA-Z), Integrimet ekonomike evropiane (Ekonomiks, Banka dhe Financa, BA-O).
  10. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Ekonomiksi i zhvillimit (Ekonomiks, BA-O), Mikroekonomi I (Banka, Menaxhment, BA-O), Makroekonomi I (Banka, Menaxhment, BA-O), Mikroekonomia e ndërmjetme (Ekonomiks, BA-O).
  11. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: International economics (Applied economics and managment, BA-O), Macroeconomics (Applied economics anf managment, BA-O), Mikroekonomi I (Marketing, BA-O), Manegarial economics BA-O, Labour economics BA-O, Economics of the public sector BA-O, Indermediate macroeconomics BA-O, Development economcis BA-O.

## V. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Organizimi dhe Teknologjia e Ndërtimit-konstruktiv, Ligji i Ndërtimit dhe Rregullativa Ndërtimore Konstruktiv, Rregullativa Ndërtimore Hidroteknikë dhe Ekonomia e Ndërtimit K.
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Aplikimi i CAD-it në Gjeodezi, Matje e Tokës, Bazat e Gjeodezisë Inxhinierike, Teknika e matjeve në Gjeodezi,



Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave, Matjet Inxhinierike (përfshihen minierat)

3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Gjeologjia e Ndërtimit dhe Gjeologjia Inxhinierike.
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për lektor për lëndët: Gjuhë Angleze.
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Menaxhimi i Mbeturinave të Ngurta, Ligji mbi Mbrojtjen e Ambientit, Vlerësimi i ndikimeve ambientale, Kontrolli i ndotjes së ajrit, Mbrojtja e Ambientit Konstruktiv dhe Mbrojtja e Ambientit Hidroteknikë.
6. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Konstruksionet prej Druri, Strukturat prej Drurit të Lameluar, Strukturat Murature, Ndërtimi Montazh, Strukturat Inxhinierike, Konstruksionet e Betonit (H), Projektimi i strukturave prej BA, Elementet e parapërgatitura prej BA.
7. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Mbrojtja dhe përforcimi i dherave, Fundimet e Veçanta, Tunelet, Inxhinieria Gjeoteknike, Bazat e Gjeoteknikës, Projektimi i rrugëve K, Projektimi i rrugëve H, gjeologjia Inxhinierike, Inxhinieri Gjeoteknike, Punët tokësorë dhe mekanizim.
8. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Materialet Ndërtimore H, Teknologjia e Betonit, Materialet Polimere dhe Aplikimet në Inxhinierinë e Ndërtimit, Materialet e ndërtimit IA, Materialet ndërtimore I K dhe Materialet ndërtimore II K.
9. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Teoria e Strukturave I, Teoria e Strukturave II, Analiza Jolineare e Strukturave, Stabiliteti i Strukturave dhe Strukturat Hapësinore.
10. Katër bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Bazat e gjeoinformatikës, Bazat e të dhënave, Rrjetat gjeodezike, Web Hartografi, Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave, Sistemet e Navigimit Global Satelitor (GNSS), Rregullimin e tokave, Web GIS, Bazat e të gjeodezisë inxhinierike, Instrumente gjeodezike, teknika e matjeve në gjeodezi, Matje në terren me instrumente gjeodezike, Regjistrimi dhe Vlerësimi i patundshmërive, Hulumtimet nga largësitë, Menaxhimi i tokës, Fotogrametria e avancuar digjitale, Matjet Inxhinierike dhe Vrojtimi i tokës, Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Metodat e barazimeve, Hartografi Topografike, Përdorimi i Gjeoinformacioneve, hartografi, Bazat e GIS-it, Hartografi Matematikë dhe Skenimi laserik tredimensional në gjeodezi, Gjeoinformatikë, Gjeovizualizimi, Teoria e Avansuar e gabimeve, Shkenca e gjeoinformacionit dhe Analiza Hapësinore, Modelimi virtual kartografik, Gjeodezia fizike dhe tektonika, Aplikimi i GIS në menaxhimin e ujërave dhe teknika e matjeve në gjeodezi H.

## VI. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Siguria në kompjuter, Biometrics & Forensics.
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Procesimi i Gjuhëve Natyrale, Germimi i të dhënave.
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Testimi i softuerit, Big data, Nxjerrja e informatave.
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Visual Computing, Analiza e Rrjetave.
5. Katër bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime për lëndët: Bazat e programimit, Algoritmet dhe strukturat e të dhënave.
6. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Testimi i Softuerit, Qarqet Digjitale.
7. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Arkitektura e Kompjuterëve, Siguria ne Internet.
8. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Siguria në kompjuter, Siguria e të dhënave.
9. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Rrjeta kompjuterike, Inxhinieria softuerike.
10. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Dizajni dhe Analiza e Softuerit, Sistemet e orientuara në shërbime.
11. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Sistemet inteligjente multimediale, Qarqet Digjitale.
12. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Programimi i pajisjeve mobile, Cloud Computing.
13. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Elektronikë, Elektronika energjetike, Qarqe Digjitale, Elektronika analoge, Komponente elektronike.
14. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Elektronikë, Sensorët dhe aktuatorët, Arkitektura e kompjuterëve, Sistemet e komunikimeve optike.
15. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Elektronikë digjitale, Optoelektronikë, Instrumentacioni matës dhe DAQ, Qarqet digjitale, Elektronikë energjetike e avancuar.
16. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Mikroprocesorët dhe Mikrokontrollerët, Mikroelektronikë, Akustika në komunikime, Teknologjia e komunikimeve optike, Qarqet mikroelektronike digjitale.
17. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Dirigjuesit e programueshëm logjik, Bazat e robotikës, Aktuatoret e mençur dhe ngasjet, Komunikimet në automatikë, Interneti i gjërave, Sistemet digjitale te rregullimit.
18. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Sensorët e mençur, Sensorët dhe aktuatorët, Automatizimi i proceseve industriale, Sensorët dhe aktuatorët në robotikë, Automatizimi i objekteve të banimit, Rregullimi në kohë reale, Robotika dhe automatizimi, Ndërfaqja njeri-makinë,
19. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Sinjalet dhe sistemet, Bazat e Inxhinierisë Elektrike 1, Bazat e Inxhinierisë Elektrike 2, Fushat dhe valët elektromagnetike, Akustika e të folurit dhe muzikës, Filtrat analog dhe digjital.
20. Dy bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime për lëndën Mikroprocesorët dhe Mikrokontrollerët.
21. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndën: Komunikimet e avancuara Optike.

22. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Rrjetet e avancuara komunikuese, Transmetimi i te dhënave, Rrjete komunikuese.
23. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Bazat e Inxhinierisë Elektrike 1, Bazat e Inxhinierisë Elektrike 2.
24. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Sinjalet dhe Informacionet, Komunikimet digjitale, Komunikimet pa tela 2.
25. Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime për lëndët: Algjebër lineare dhe Kalkulus 1, Kalkulus 2.
26. Dy bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime për lëndët: Fizikë 1, Fizikë 2.
27. Një bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime për lëndët: Kalkulus 3 me Probabilitet, Matematikë diskrete me Probabilitet, Kalkulus 2.

## VII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Gjuhë Angleze I dhe II.
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Gjuhë Angleze I dhe II.
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: Gjuhë Gjermane I dhe II.
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Gjuhë Gjermane I dhe II.
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndën: Fizika.
